

HYRJE

Procedura kontestimore është një nga procedurat civile më të rëndësishme dhe një nga procedurat më të rëndësishme të drejtësisë. Ofrimi i mbrojtjes gjyqësore për shkeljen e të drejtave subjektive të personave fizik dhe juridikë paraqet një nga qëllimet kryesore të kësaj procedure. Nëpërmjet kësaj mund të themi se procedura civile, si bazament kryesor ka njohjen, konstatimin dhe realizimin e të drejtave subjektive, ku vlen të ceket se kjo procedurë i është lënë në tërësi diskrecionit të palës, sa i përket inicimit të saj.

Në Republikën e Kosovës, procedura kontestimore është sistem i rregullave që ka pësuar ndryshime dhe nuk ka mbetur procedurë e stagnuar duke pasur parasysh se Gjykatat e Rep. Të Kosovës me 6 tetor 2008 kishin filluar t'a zbatonin Ligjin e ri të Procedurës Kontestimore ku si bazë shërbente Ligji i 1982 i kësaj procedurë, ndryshimet e bëra në Ligjin e ri kanë sjellur zgjidhje për problematikat e krijuara sa i përket afateve, veprimeve procedurale, seancave gjyqësore etj, e që kjo për menimin tim i shërben sistemit të drejtësisë sepse tentohet të arrihet perfeksionimi i rregullave që ofrojnë mbrojtjen nga gjykata për të drejtat subjektive të personave fizik dhe juridik dhe eliminimin e paqartësive në Ligj, ku e bëjnë më të lehtë zbatimin tij.

Përmes studimit të fenomeneve juridike dhe hartimit të preventivave për shmangien e situatave josolvente, ndërliidhemi me një nevojë të shprehur për të pasur një infrastrukturë të nevojshme ligjore për mbrojtjen efikase të së drejtave subjektivem, ku gjith aktiviteti i ndërmarrur në këtë procedurë zhvillohet në Gjykata. *Procedura e kontestimore është fazë e cila fillon me padinë e paditësit dhe përfundon me aktgjykimin e Gjykatës. Pra ofrimi i mbrojtjes gjyqësore dhe në kohë të arsyeshme (siç parashihet edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut), rrisin besimin e qytetarëve në Gjykatat tona dhe në të njëjtën kohë ofron zgjidhje për kontestet ndërmjet palëve në procedurë.*

Edhe pse në vendet e rajonit dhe më gjerë, procedura kontestimore ka shënuar një trend të lartë të zhvillimit, si në aspektin studimor ashtu edhe në praktikën gjyqësore, kjo tek ne lë ende shumë për të dëshiruar, prandaj me theks të veçantë potencoj se rëndësia e studimit dhe përpunimit

kësaj disiplinë, si në fushën teorike ashtu edhe atë të praktikave gjyqësore në Republikën e Kosovës kërkon angazhim më të lartë.

Njëra nga kriteret kryesore për studimin e kësaj dege qënësore për drejtësinë po ashtu edhe e nevojshme për dinamikën e zhvillimit të saj, është edhe infrastruktura e nevojshme ligjore dhe praktikave gjyqësore, bashkë me këto zhvillohet një procedurë e mirëfillët dhe e shpejtë e cila shërben në favor të palët por gjithashtu në favor të drejtësisë.

Qëllimi i këtij punimi paraqitet si nevojë e studimit më të thelluar të institutit për kthimin e gjendjes së mëparshme dhe paraqitjen e një analizë të plotë, të gjithanshme, në të drejtën tonë pozitive. Ky institut është i një rëndësie qënësore në procedurën kontestimore, por më e rëndësishme është zbatimi apo përdorimi i tij praktik në konteste civile.

Procedura e paraqitjes së propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme duhet bërë me rregullat dhe parimet të cilat i parasheh edhe Ligji për Procedurën Kontestimore, ku qëllimi kryesor i këtij mjete është që pala të mund t'a shfrytëzojë të drejtën e tij për ndërmarrjen e ndonjë veprimi procedural në rastet kur afati ka kaluar, pra studimi dhe analizimi i këtij instituti duhet gjithmonë të jetë në harmoni me qëllimet kryesore të Procedurës Kontestimore dhe të mos shkelen të drejtat e subjekteve në procedurë, njëkohësisht edhe ofrimi i mbrojtjes gjyqësore duke mundësuar përdorimin e këtij mjete në mënyrë të arsyeshme.

Praktika Gjyqësore është kusht parësor për zhvillimin e institutit për kthimin në gjendjen e mëparshme ,përmes analizave të praktikave gjyqësore, ku këto të fundit shërbejnë për shtimin e efikasitetit në kontestet civile, tentohet të arrihet edhe suksesi i njohjes, konstatimit dhe realizimit të së drejtave subjektive.

Instituti për kthimin në gjendjen e mëparshme edhe pse është i një rëndësie mjaftë të madhe nuk është se ka elaborim të mjaftueshëm në jetën juridiko – shkencore, për këtë arsye, kam vendosur të jap maksimumin e kontributit tim profesional dhe shkencor me qëllim që zbatuesit të ligjit si dhe komunitetit juridik në tërësi t'ia bëjë më të lehtë kuptimin e këtij instituti si dhe të gjitha elementeve që e karakterizojnë atë. Mendoj se nga ky hulumtim do të ketë përfitime të mëdha disa grupe shoqërore siç janë: grupi i juristëve, komuniteti gjyqësor, avokatura etj.